




**BPrAL AAB**  
CILËSI. LIDERSHIP. SUKSES!



## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet

**KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS**

dhe

**KOLEGJI AAB - FAKULTETIT JURIDIK**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Qëllimi i këtij Memorandumi është krijimi i bashkëpunimit në mes të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Fakultetit Juridik të Kolegjit AAB, për mundësinë e mbajtjes së praktikës dhe vizitave studimore për studentët e Fakultetit Juridik në Gjykatat e Republikës së Kosovës.

**Neni 2**

### **Obligimet e Fakultetit Juridik**

- 2.1** Sigurohet se puna praktike dhe vizitat studimore të studentëve në Gjykatat respektive të vlerësohet dhe konsiderohet si pjesë shtesë e mësimit teorik të studentëve.
- 2.2** Njofton (KGJK) me kohë se kur mund të dërgohen studentët për vijimin e praktikës , sipas nevojave të Gjykatave dhe pëlqimit të (KGJK), siguron numrin e studentëve që do të vijojnë praktikën.
- 2.3** Përgaditë dhe mirëmban regjistrin me emrat e studentëve dhe kohën në të cilën ata do ta kryejnë praktikën në Gjykatat e Kosovës si dhe ia dërgon Gjykatës së caktuar listën e studentëve për vijimin e punës praktike një javë para fillimit të mbajtjes së sajë.

### Neni 3

#### Obligimet e (KGJK)

- 3.1 Në koordinim me Fakultetin Juridik u mundëson studentëve të këtij fakulteti mbajtjen e praktikës për periudhën e caktuar kohore të përcaktuar nga Gjykatat.
- 3.2 Njofton Fakultetin Juridik, me kohë, për numrin e studentëve që mund të kryejnë praktikën sipas kriterëve të caktuara.
- 3.3 Gjykatat kompetente ku studentët kanë përfunduar praktiken, sipas mundësisë ti paisin studentët me vërtetim mbi përfundimin e praktikës, i cili do t'ju shërbej studentëve për vlersimi pikësh në notimin final.

### Neni 4

#### Bashkëpunimi profesional

Palët pajtohen të organizojnë aktivitete të përbashkëta profesionale (ligjerata, tryeza, konferenca etj.) me qëllim të shkëmbimit të praktikave në drejtim të rritjes së cilësisë së studimit për studentët.

### Neni 5

#### Kohëzgjatja e Memorandumit

- 5.1 Memorandumi i mirëkuptimit nënshkruhet për periudhën 3 (tre) vjeçare, me mundësi vazhdimi.
- 5.2 Në rast se asnjëra nga palët nënshkruese nuk e paralajmëron shkëputjen e këtij Memorandumi, një muaj para përfundimit të tij, i njëjti konsiderohet së është vazhduar edhe për një vit.


### Neni 6

#### Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.



Këshilli Gjyqësor i Kosovës  
Z. Skender Çoçaj  
Kryesues



Kolegji AAB - Fakulteti Juridik  
Prof. Ass. Dr. Veton VULA  
Dekan